

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA PËRMBARIMORE

SUELA NDRECA

Nr. 389/5 Prot

Tiranë, më 20.06.2023

Nr. 389 Dosje

URDHËR PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Për dijeni: **Debitorit:** Shoqërisë “Pashkashesh” sh.p.k.
Administrator Z. Arben Kalemi
Adresa: fshati Pashkashesh, Komuna Bërzhitë, Tiranë

Kreditorit: Shoqërisë “ENO TD” sh.p.k.
Administrator Z. Tonin Dedaj
Adresa: Lagjia nr.14, Autostrada Durrës Tiranë, pranë karburant Kastrati, Durrës


Unë, Suela Ndreca, Përmbarues Gjyqësor, në referim të titullit ekzekutiv Faturë Tatimore e Shitjes me TVSH me Nr.25 datë 01.11.2016 (vlera me TVSH e detyrimit 200,000 lekë); Faturë Tatimore e Shitjes me TVSH me Nr.12, Nr, serie 71366612 datë 07.12.2018 (vlera me TVSH e detyrimit 214,200 lekë); Faturë Tatimore e Shitjes me TVSH me Nr, serie 71363923 Nr. 23 datë 18.12.2019 (vlera me TVSH e detyrimit 120,000 lekë); Faturë Tatimore e Shitjes me TVSH me Nr, 471/2022 datë 19.02.2022 (vlera me TVSH e detyrimit 400,000 lekë) lëshuar Shoqërisë “Pashkashesh” shpk me NIPT K51718007A, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 389 kërkesën e kreditorit Shoqërisë “ENO TD” sh.p.k., ndaj debitorit Shoqërisë “Pashkashesh” sh.p.k.

Në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile është marrë Vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Përsa më sipër në referim të nenit 527 e në vijim të K.Pr.Civile të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 26/2019 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”,

URDHËROJ:

1. Qendrën Kombëtare të Biznesit, të bëjë vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi dokumentacionin e aktiveve, kuotat/aksionet e palës debitore si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre, moskryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar, si dhe të mospajisë me asnjë lloj dokumentacioni debitorin Shoqërinë “Pashkashesh” sh.p.k. NIPT K51718007A, Administrator Z. Arben Kalemi, Adresa: fshati Pashkashesh, Komuna Bërzhitë, Tiranë.



- 
2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorët e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
 3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së mjeteve të luajtshme në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
 4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve.

Përmbarduesi GJYQËSOR
Suela NDRECA

